

EC

MA NDRYSHE

EKO SHKOLLA

- REDUKTO - RIPËRDOR - RIKIKLO -

EKO KLUBI "LORENC ANTONI"

1



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

CARITAS

Schweiz
Suisse
Svizzera
Svizra

YENI

YOUTH
ENVIRONMENTAL
IMPACT



Të dashur lexues,

EC ka filluar publikimin e buletineve mjedisore të eko-klubeve të shkollave të mesme nga Rajoni i Jugut (komuna e Prizrenit, Mamushës, Rahovecit dhe Malishevës). Ky është buletini i parë informativ, i cili do të përmbajë mesazhe, intervista, ese, punime fotografi dhe shkrime të ndryshme mbi mjedisin dhe ndryshimet klimatike dhe njoftime mbi punën që po zhvillohet në këto tema nga eko-klubi i Shkollës së Mesme të Lartë "Lorenc Antoni" dhe OJQ EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit "ECO School".

Ky projekt do t'i njohë me konceptin "Eko Shkolla" 12 shkollat e rajonit të Jugut (komuna e Prizrenit, Mamushës, Rahovecit dhe Malishevës), përmes pilotimit të formave dhe metodologjisë për mbrojtjen e mjedisit me pjesëmarrje të gjerë të nxënësve dhe mësimeve.

Në kuadër të projektit ofrohet një model dhe metodologji që përdoret gjerësisht në vendet e zhvilluara, e cila po zgjerohet me shpejtësi edhe në vendet në zhvillim. Përvojat botërore tregojnë se shkolla ekologjike është një fenomen në rritje, e cila nxit të rinjtë të angazhohen në mjedisin e tyre duke u dhënë atyre mundësinë për ta mbrojtur atë në mënyre aktive.

Projekti po ashtu do të kontribuojë në Strategjinë e Mjedisit dhe Planin e Veprimit në Mjedis të Kosovës, duke rekomanduar zhvillimin e programeve për edukimin mjedisor në të gjitha nivelet (shkolla dhe universitete).

NDOTJA E AJRIT

Ajri është një element mjaft i rëndësishëm për shëndetin e njeriut dhe për mjedisin që na rrethon, i cili vazhdimisht është nën ndikim të ndotjes. Edhe pse ndotja e ajrit vjen nga aktivitetet njerëzore, ai gjithashtu mund të ndikohet edhe nga fenomenet natyrore.

Ndotja e ajrit ndodh kur në ajër lirohen substanca në sasi që mund të dëmtojnë shëndetin e njerëzve, kafshëve dhe bimëve ose mund të shkaktojnë dëme materiale. Disa ndotës të ajrit mund të kenë edhe ndikime globale p.sh. rritja e efektit të gazeve serra ose dëmtimi i shtresës së ozonit.

Ndotja e ajrit dëmton biodiversitetin e planetit tonë. Ajri që thithim është përplot ndotës toksik dhe i rrezikshëm. Cdo vit miliona njerëz vdesin për shkak të çështjeve të ndryshme që lidhen me ndotjen. Duhet të identifikojmë burimet e ndotjes së ajrit dhe të gjejmë mënyra realiste për të luftuar ndotjen e ajrit.

Ndotja e ajrit ndikon në mjedis pasi mund të parandalojë fotosintezën në bimë, e cila përfundimisht ka pasoja të rënda në ajrin që thithim. Gjithashtu, kontribuon në formimin e shiut acidik.



PËR TË PARANDALUAR NDOTJEN E AJRIT DHE MJEDISIT NE DUHET TË:

- Përdorim transportin publik

Mundohuni të ecni në shkollë ose në punë kur është e mundur. Ndani udhëtimet me të tjerët që shkojnë në të njëjtin drejtim ose përdorin transportin publik.

- Shmangim çdo lloj aktiviteti në natyrë kur nivelet e ndotjes së ajrit janë ngritur

Mos ushtrohuni në afërsi të rrugëve të ngjeshura me trafik, pasi gazrat e prodhuara nga trafiku rrisin ndjeshëm rrezikun e sistemit tonë të frymëmarrjes.

- Fikim pajisjet / dritat elektrike kur nuk janë në përdorim

Mos i mbani ndezur dritat nëse nuk jeni në dhomë. Mos i mbani pajisjet elektrike në modalitetin e pritjes, sepse edhe pse ato konsumojnë një sasi të caktuar të energjisë elektrike.

- Fillojmë të përdorim energjinë diellore (solare)

Ne e kuptojmë që jo çdo shtëpi në Ballkan mund të përballojë panelet diellore, por ato po bëhen më të lira sot, dhe shpresojmë se një ditë së shpejti do të përdorim më shumë burimin e energjisë diellore sesa energjinë e prodhuar në mënyra tradicionale.

- Përdorim produkte të riciklueshme

Kjo këshillë vjen sepse zakonisht duhet më pak energji për riciklimin e një produkti sesa për të bërë një të ri.




PËR TË PARANDALUAR NDOTJEN E AJRIT DHE MJEDISIT NE DUHET TË:

- Zvogëloni përdorimin e qeseve plastike me përdorim të vetëm

Duhen më shumë se 500 vjet që një qese plastike të dekompozohet në një deponi. Përdorni kanavacë / çanta pambuku ose qese letre të ripërdorshme në vend të qeseve plastike.

© [HTTPS://WWW.IBCMITROVICA.EU/INFORM/SQ/MASAT-QE-MUND-TE-NDERMERRNI-PER-TE-ZVOGELUAR-NDOTJEN-E-AJRIT/](https://www.ibcmitrovica.eu/inform/sq/masat-qe-mund-te-ndermerrni-per-te-zvogeluar-ndotjen-e-ajrit/)



NDOTJA MJEDISORE NGA PLASTIKA


Ndotja nga plastika përfshin grumbullim të produkteve plastike në botën që na rrethon. Materialet plastike konsumohen sepse ato kanë përdorim të gjithanshëm, janë të forta, janë rezistente, shpesh janë të lehta, dhe nuk janë shumë të shtrenjta. Këto cilësi e bëjnë plastikën shumë tërheqëse për t'u përdorur nga njerëzimi.

Përveç këtyre efekteve të dëshiruara, materialet plastike kanë edhe anët e tyre negative. Kështu, materialet plastike karakterizohen nga një dekompozim i ngadaltë i cili shkon nga 100-500 vjet apo edhe deri në 1000 vjet. Për shembull, një qese plastike kërkon një kohë rreth 20 vjet që të dekompozohet ndërsa një rrjetë detare kërkon një periudhë kohore prej 600 vjetësh. Makroplastikat janë materiale që kanë përmasa mbi 2,5 cm. Ne i shohim ato me sy të lirë, shpesh të hedhura në hapësira të ndryshme, të tilla si bidona uji, tapa shishesh, shishe detergjentësh, kuti ushqimesh, shapka plazhi, pajisje kozmetike plastike, qese plastike, tuba etj.



AKTIVITETET E EKO-KLUBIT:

TAKIMI MES EKO-KLUBIT DHE
EÇ MA NDRYSHE



EKO KLUBI "LORENC ANTONI"

RR. MARIN BARLETI, PRIZREN, KOSOVË

Autor dhe botues: EC Ma Ndryshe
Rr. Fehmi Lladrovci Nr.94, Prizren & Rr. Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 Nr.7,
Prishtinë
www.ecmandryshe.org
info@ecmandryshe.org
029 222 771 & 038 224 967

Ky buletin u realizua në kuadër të projektit “Ndikimi i Rinisë në Mjedis” - YENI, i cili bashkëfinancohet nga Agjencia Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim, Caritas-i Zviceran, Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe implementohet nga OJQ EC Ma Ndryshe përmes projektit “ECO Schools”.